



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**

Mbledhja nr.06/2017

Prishtinë, më 30.11.2017, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha– Shala, kryetare, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari– Lila, Memli Krasniqi, Gani Dreshaj dhe Bilall Sherifi, anëtarë.

**Munguan:** Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Dardan Molliqaj, Qëndron Kastrati dhe Duda Balje, anëtarë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Dardan Abazi – INDEP.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 2 dhe 7.11.2017;
3. Njoftim i komisionit nga Zyra e Rregullatorit për Energji – ZRRE, rreth Vendimit të Gjykatës së Apelit për pezullimin e Vendimit të ZRRE-së (V-399-2012) dhe vështirësitë, me të cilat po ballafaqohet NP KEK, në nxjerrjen e linjtit, si pasojë e moszhvendosjes së shtëpive në fshatin Shipitullë dhe Hade;
4. Shqyrtimi i nismës legislative: “Projektligji për miniera dhe minerale”;
5. Të ndryshme.

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Sala Berisha-Shala, kryetare,** propozoi që pika e tretë e rendit të ditës: “Njoftim i komisionit nga Zyra e Rregullatorit për Energji – ZRRE, rreth Vendimit të Gjykatës së Apelit për pezullimin e Vendimit të ZRRE-së (V-399-2012) dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohet NP KEK, në nxjerrjen e linjtit, si pasojë e moszhvendosjes së shtëpive në fshatin Shipitullë dhe Hade”, të hiqet nga rendi i ditës, pasi që duhet të jenë në takim edhe përfaqësuesit e ZRRRE-së dhe është interesimi i madh edhe i mediave dhe shoqërisë civile lidhur me këtë çështje, kështu që do ta trajtojmë në një mbledhje tjetër.

*Rendi i ditës u miratua me propozim të kryetares.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 2 dhe 7.11.2017**

*Procesverbalet e mbledhjeve të datës 2 dhe 7.11.2017, u miratuan pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i nismës legislative: “Projektligji për miniera dhe minerale”**

**Kryetarja,** si kryesuese edhe e grupit të punës, para komisionit e arsyetoi nismën legislative. Po ashtu, potencoi se ky projektligj, me nismë të komisionit, ishte hartuar në legjislaturën e kaluar në fillim të vitit 2017 dhe ishte proceduar për mendim në Qeveri. Mirëpo, për shkak të shpërndarjes së Kuvendit ka mbetur pa u proceduar më tutje. Gjatë hartimit, procesi i konsultimit publik me grupet e interesit, grupi punues e ka zhvilluar nëpërmjet organizimit të tryezës, të mbështetur nga INDEP-i, në të cilën tryezë kanë marrë pjesë: KPMM-ja, MZHE-ja, Oda Britanike në Kosovë - BCCK, “Peshter Mining” JSC, Fakulteti i Gjeoshkencave – Mitrovicë, ekspertë të xehetarisë, Oda Ekonomike Amerikane, BGF/KOSID, Oda Tregtare Kosovare-Turke, Shoqata e gurthyesëve, “Sharrcem”, GSLP, KDI, OJQ “Gjeomjedisi”, MBPZHR, OJQ “Lansodë”, “Gora Region”, TTI “Durchhalten”. Kjo nismë legislative ka ardhur si rezultat i rekomandimeve të Kuvendit nga mbikëqyrja e zbatimit të ligjit në fuqi për miniera dhe minerale, mbikëqyrje që është realizuar gjatë vitit 2016. Drafti i tanishëm i projektligjit nuk ka ndonjë dallim përmbajtësor nga drafti i legjislaturës së kaluar. Siç jeni në dijeni, komisioni, në mbledhjen e datës 24.10.2017, ka vendosur të marrë nismën legislative për hartimin e Projektligjit për miniera dhe minerale. Grupi punues, në takimin e tij të parë, më 7.11.2017, pas diskutimeve, vendosi që në grup punues të përfshihen ZKM-ja, KPMM-ja, MZHE-ja, MMPH-ja dhe shoqëria civile (INDEP-i). Mbledhja e radhës e grupit punues, me përbërje të zgjeruar, u mbajt më 9.11.2017, ku u diskutua për qasjen që do të ndjekë grupi punues në hartimin e projektligjit. Në këtë mbledhje u vendos që të mbahet një punëtori për hartimin e projektligjit. Punëtorja u mbajt më 15 dhe 16 nëntor 2017, në të cilën punëtori u punua në hartimin e projektligjit dhe nga kjo punëtori doli ky drafti i projektligjit që e kemi tani.

*Pas debatit, komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

### *Përfundim*

- 1. Miratohet nisma legislative: “Projektligji për miniera dhe minerale;*
- 2. I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, që ta procedojë për në Qeveri, për dhënien e opinionit.*

#### 4. Të ndryshme

##### a) Takimi me z. Kanez Kopaç, drejtorin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë

**Kryetarja** i njoftoi anëtarët e Komisionin se drejtori i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, z. Janez Kopaç, ka kërkuar takim me komisionin dhe ka propozuar dy data 13-15 dhjetor 2017.

**Hykmete Bajrami**, kërkoi nga stafi i komisionit që, para takimit me z. Kopaç, që ta marrin një njoftim lidhur me funksionimin e Sekretariatit dhe obligimet e Kosovës në këtë mekanizëm.

**Mimoza Kusari- Lila**, tha se pajtohet që takimi të mbahet më 15 dhjetor 2017, duke filluar nga ora 9:00.

*Me këto propozime u pajtuan edhe anëtarët tjerë të komisionit.*

##### b) Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligji nr. 06/L-019 për standardizim

**Kryetarja**, kërkoi nga anëtarët e komisionit, që të formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligji nr.06/L-019 për standardizim, pasi që është miratuar nga Kuvendi në parim, ndërsa nga komisioni ka mbetur formimi i grupit punues.

*Pas propozimeve, komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

#### *Vendim*

- 1. Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligji nr. 06/L-019 për standardizim;*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Mimoza Kusari – Lila, kryesuese, Adem Hoxha dhe Dardan Molliqaj, anëtarë;*
- 3. Grupi punues, në bashkëpunim me njësinë koordinuese të komisionit, të hartojë planin e veprimt dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në komision.*

##### c) Kërkesa për takim më nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

**Kryetarja** i njoftoi anëtarët e komisionin për një kërkesë nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për takim pune, për këtë mund të vendosim, për t'i takuar në Kuvend ose mund të shkojmë për t'i vizituar.

*Komisioni u pajtua me propozimin e kryetares.*

**Mbledhja përfundoi në orën 15:30.**

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**

**Sala Berisha – Shala**

---